



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME**  
Nr.01-060/01-15101/24 datë:18.06.2024



Npi – 01/218 datë: 26.06.2024

Duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja (d) dhe nenin 40.2 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenin 60 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048; Si dhe bazuar në Qarkoren Buxhetore 2025/01 e lëshuar nga Ministria e Financave me datën 15.05.2024, me numër protokoli Nr.1259/2024, dhe pas diskutimit publik me qytetarë, dhe me grupe të interesit, Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e mbajtur më: 26.06.2024, miratoi këtë:

**V E N D I M**

**MIRATOHET KORNIZA AFATMESME BUXHETORE E KOMUNËS SË SHTIMES  
PËR PERIUdhËN 2025-2027**

**I**

Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e -VI- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më: 26.06.2024, me shumicën e votave miratoi, Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Shtimes për periudhën 2025-2027.

**II**

Kuvendi i Komunës mori parasysh Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa Npi-01/217 të datës 24.06.2024, Rekomandimin e Komitetit për Komunitete, Npi-01/214 të datës 21.06.2024, si dhe Diskutimet Publike me qytetarë nëpër fshatra dhe lagje urbane, Procesverbalet me numër protokoli Nr.02/678 deri 02/692.

**III**

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Zyrës për Financa, Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Ministrisë për Financa dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit  
Adnan Ademi